

## MARRËVESHJE MOBILITETI

**Prishtina REA**, me adresë zyrtare në rr. Zagreb, H.23, nr.08, Prishtinë, legalisht përfaqësuar nga z.  
Ahmet Jetullahu, i lindur më 12.01.1972, me vendbanim në Prishtinë, tash e tutje definuar si  
“Organizata Koordinuese në Republikën e Kosovës”

dhe

Emri dhe Mbiemri i Studentit

---

Data e lindjes

---

Nacionaliteti

---

Adresa

---

Tel/mob.

---

E- mail

---

**PALËT PAJTOHEN SIKUR MË POSHTË:**

### **NENI 1 - OBJEKTI**

1.1 Projekt Intervet WB do të ofroj përkrahje financiare për Pjesëmarrësin për realizimin e një periudhe Mobiliteti jashtë vendi.

1.2 Pjesëmarrësi pranon përkrahjen financiare sikurse përshkruar në Nenin 3, dhe zotohet të përfundoj periudhën e Mobilitetit, sikurse ofruar përmes Kushteve të Përgjithshme, e cila paraqetë pra formën integrale të kësaj marrëveshjeje.

1.3 Çdo modifikim nga kjo marrëveshje kërkohet dhe autorizohet nga të dyja palët përmes një Letre Zyrtare ose përmes emailit.

## **NENI 2 – PERIUDHA E VALIDITETIT TË KONTRATËS DHE KOHËZGJATJA E MOBILITETIT**

2.1 Kjo kontratë hyn në fuqi më nënshkrimin e palës së fundit kontraktuale.

2.2 Periudha e mobilitetit do të ketë një kohëzgjatje prej 28 ditësh (+ 2 udhëtimi) dhe do të implementohet përgjatë një kohe në mes 01/09/2023 dhe 30/09/2023.

2.3 Pjesëmarrësi pranon përkrahje financiare për një periudhë prej 30 ditësh

2.4 Certifikatë / Traineeship Certificate lëshuar nga organizata nikoqire duhet të ofrohet dhe të konfirmoj datën e fillimit dhe mbarimit të periudhës së mobilitetit.

## **NENI 3 – PËRKRAHJA FINANCIARE**

3.1 Projekti **Intervet WB** ofron një kontributë për të mbuluar kostot e akomodimit, transportin lokal, udhëtimet dhe një kontributë për ushqim, mbrenda limiteve të vendosura nga ana e projektit. Organizata Dërguese duhet të siguroj që standardet e nevojshme të kualitetit dhe sigurisë përmbushen me rastin e ofrimit të kësaj përkrahjeje. Kontributi sikur më lartë do të mbulohet direkt nga nikoqiri dhe partneri dërgues.

3.2 Është obligative pjesëmarrja e plotë në programin e internshipit jashtë vendi, përveç ballafaqimit me probleme shëndetësore, të çertifikuara nga ana e mjekut të licensuar

3.3 Përkrahja financiare osë pjesë e saj duhet të kthehet të organizata dërguese nëse Pjesëmarrësi nuk i përmbushë dhe respekton provizionet e kësaj marrëveshje. Nëse Pjesëmarrësi e ndërpre në periudhën e mobilitetit para afatit të paraparë, ai/ajo duhet të reimburse shumën e kontributit të paguar dhe rezultatet nuk mund të raportohen. Nëse Pjesëmarrësi nuk e përfundon aktivitetin e mobilitetit, për arsye madhore “force majeure”, të tilla raste duhet të raportohen te organizata dërguese dhe të pranohen poashtu. Në rast të mos-pranimit nga ana e Komisionit European kthimi i mjeteve financiare të pranuar, te projekti do të jetë obligim i Pjesëmarrësit.

## **NENI 4 - SIGURIMI**

4.1 Pjesëmarrësi duhet të mbulohet përmes sigurimit adekuatë.

4.2 Për qëllime të mbulimit të sigurimit shëndetësor në lidhje me probleme shëndetësore, është përfshirë edhe sigurimi për këtë periudhë. Numri i Sigurimit Shëndetësor do të komunikohet para nisjes.

4.3 Për qëllime të mbulimit të mbrojtjes civile, e cila mbulon çfardo dëmtimi shkaktuar nga ana e Pjesëmarrësit në vendpune, është përfshirë një sigurim dedikues poashtu. Numri i këtij

Sigurimi do të komunikohet para nisjes.

4.4 Për qëllim të mbulimit të sigurimit kundrejt aksidenteve të shkaktuara nga detyrat e antarëve në vend punë, është përfshirë një sigurim i dedikuar poashtu. Numri i këtij Sigurimi do të komunikohet para nisjes, kostot shëndetësore nuk janë të përfshira nën këtë sigurim e që kanë të bëjnë me mbulimin e menagjimit të sëmundjeve. Për shëmbull, ri-atdhesimi, operacionet, trajtimet dentale nuk janë të përfshira në këto sigurime por do të trajtohen në Nenin 4.2

#### **NENI 5 – INVESTIGIMI I PROJEKTIT**

6.1. Pjesëmarrësi duhet të përfundoj dhe dorëzoj një intervistë on-line (video-intervistë) në fund të periudhës së mobilitetit dhe për çdo rrethanë mbrenda tridhjetë ditëve kalenderike nga data e pranimit të ftesës për të kompletuar pyetsorin nga ana e organizatës dërguese. Për Pjesëmarrësit të cilët nuk kanë përfunduar dhe dërguar pyetësorin online, organizata dërguese është e ngarkuar të kërkoj reimbursimin total ose të pjesësishëm të përkrahjes financiare, të pranuar dhe ka një rezultat të pavlefshëm.

#### **NENI 7 – LIGJET E APLIKUESHME DHE GJYKATA KOMPETENTE**

7.1 Kjo Marrëveshje administrohet sipas provizioneve ligjore bazuar në ligjet nacionale për grante.

7.2 Gjykata kompetente, bazuar në legjislacionin në fuqi, obligohet të menagjoj kundërshtitë në mes palëve, pra Organizatës dërguese dhe Pjesëmarrësit në lidhje me aplikimin, interpretimin dhe validitetin e provizioneve të kësaj marrëveshjeje, nëse të tilla kundërthënjë nuk mund të zgjedhen në mes palëve reciprokisht.

#### **KUSHTET E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1: Përgjegjësia**

Secila palë kontraktuese përjashton palën tjetër nga çdo përgjegjësi civile për dëmet e pësuar nga ai ose stafi i tij si rezultat i kryerjes së kësaj kontrate, me kusht që dëmet të mos jenë rezultat serioze i sjelljes dhe i qëllimshëm.

Pjesëmarrësi deklaron që ka qenë i informuar rreth modaliteteve korrekte të sjelljes gjatë përvojës jashtë vendi, sikur prezentuar gjatë trainimit para-nisjes në vendin e origjinës.

Komisioni European dhe stafi i tij nuk do të jenë përgjegjës në rast të ankesave që kanë të bëjnë me dëmtimet e shkaktuara gjatë realizimit të mobilitetit. Si konsekuencë, Komisioni European nuk do të marrë në konsideratë çfarido ankese për dëmtimet/lëndimet nga secila palë nënshkruese e marrëveshjes.

## **NENI 2: Tërheqja dhe ndërprerja e kontratës**

Në rast se një Pjesëmarrës prishë kontratën, duke mos marrë në konsideratë konsekuencat që rrjethin nga aplikimi i legjislacionit, organizata dërguese është legalisht e autorizuar të ndërprejë Marrëveshjen pa të tjera formalitete nëse pjesëmarrësi nuk ndërmerr veprime mbrenda një muaji nga data e pranimit të letres së regjistruar/pranuar.

Nëse pjesëmarrësi tërheqet para kohe nga marrëveshja për arsye që nuk kanë të bëjnë me arsye madhore (force majeure) ose në rast që ai/ajo nuk respekton provizionet e kontratës, ai/ajo duhet të kthejë pagesat sipas shumave të parapaguara më herët.

Përndryshe, në rast të ndërprerjes së Marrëveshjes së kontratës nga ana e Pjesëmarrësit për shkak të forcave madhore (force majeure), (një situata e paparashikuar dhe e jashtëzakonshme, jashtë kontrollës së tyre dhe jo si rezultat i gabimeve ose neglizhencës), si pasojë, merr shumën e kalkuluar sipas kohëzgjatjes së qëndrimit jashtë vendi sipas kësaj kontrate, bazuar në atë që edhe është prezentuar në Nenin 2.2. Secila pjesë e mbetur e shumës duhet të kthehet, në të kundërtën pajtohet me organizatën dërguese për të njëjtën përgjegjësi.

## **Neni 3: Përpunimi i të Dhënave**

Të dhënat personale të përfshira në kontratë do të përpunohen sipas Rregullores (EC) No. 45/2001 të Parlamentit Europain dhe të Këshillit mbi mbrojtjen e individëve sa i përket përpunimit të të dhënave personale nga ana e Trupave të Unionit dhe transferit të lirshëm të të dhënave. Të dhënat do të përdoren vetëm për aktivitetet që kanë të bëjnë specifikisht me implementimin dhe follow-up e kontratës nga ana e organizatës dërguese, Agjencisë Nacionale dhe Komisionit Europian, pa paragjykime të mundësisë së bartjes së të dhënave të mekanizmat përgjegjës për inspektim dhe auditim, sipas legjislacionit të Bashkimit Europian (Gjykata e Auditorëve të Zyrës Europiane për Anti-Mashtrim).

Pjesëmarrësi mund, me kërkesë të shkruar, të ketë qasje në të dhënat e tij/saj personale dhe të procedoj me korrigjimin e informatave jo të saktë ose të pakompletuara. Pjesëmarrësi mund të kërkojë që çfardo informate në lidhje me procesimin e të dhënave të tij/saj personale. Pjesëmarrësi mund të parashtroj një ankesë me Garantues për mbrojtjen e të dhënave sensitive operuese bazuar në Dekretin Legjislativ nr. 196/2003, që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave tuaja nga ana e organizatës dërguese dhe/ose Agjencia Nacionale ose Mbikëqytësin Europian të Mbrojtjes së të Dhënave, në lidhje me përdorimin e të dhënave nga ana e Bashkimit Europian.

## **Neni 4: Kontrollat dhe Auditimet**

Palët Kontraktuale zotohen të ofrojnë të gjitha informatat e kërkuara nga ana e Komisionit Europian ose mekanizëm tjetër i autorizuar nga ana e tyre me qëllimin e verifikimit të performancës së mirë të perudhës së mobilitetit në respektim të provizioneve të kësaj kontrate.

Pjesëmarrësi poashtu është në dispozicion për të marrë pjesë në aktivitetet monitoruese dhe vlerësuese, të ndërmarra nga ana e Komisionit Europian në peridhë prej 24 muajsh pas përfundimit të aktiviteteve të

projektit dhe, mbrenda limiteve të mundësive të dakorduara, për komunikim me mekanizmat përkatës ose me ndonjë ndryshim vendbanimi etj

**Për Pjesëmarrësin:**

Emri dhe Mbiemri

---

Nënshkrimi

---

Emri dhe Mbiemri i prindit/ kujdestarit ligjor

---

Nënshkrimi i prindit/ kujdestarit ligjor

---

Vendi dhe Data.....

*Një kopje Dokumentet Identifikues me të dy anët e tij të prindit/kujdestarit ligjor të pjesëmarrësit / bashkangjitet poashtu kësaj marrëvshje*

**Për Organizatën Dërguese:**

Emri dhe Mbiemri I përfaqësuesit ligjor

\_\_\_\_\_

Nënshkrimi

\_\_\_\_\_

Vendi dhe Data.....